

789  
30.6.21

Tirane me. 06. 2021

Nr. 29/6. Prot.

**Subjekti:** *Kerkese per derogim ne lidhje me kodin e transmetimit, miratuar me vendimin e Bordit te ERE 186/2017, ndryshuar me vendmimin 129/2018.*

**Drejtuar: Z. PETRIT AHMETI**

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE**

**Adresa: Blvd “Bajram Curri”, Rr. “Viktor Eftemiu”, 1023.**

**Tiranë**

**I Nderuar Zoti Ahmeti,**

Shoqëria “POWER-ELEKTRIK-SLABINJE” sh.p.k., me numer identifikues NIPT K81813003S, është mbajtëse e licencës nr. 93, seria PV10K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s Nr. 10, datë 08.02.2010, për një afat 30-vjeçar dhe modifikuar me vendimin e bordit të ERE-s Nr. 95, datë 16.07.2012.

Shoqëria “POWER – ELEKTRIK - SLABINJE” sh.p.k., është zotëruese e Hec Sllabinje me fuqi të instaluar 13.08 MW. Hidrocentrali nepermjet nje nenstacioni ngrites TM/110 kV lidhet me rrjetin e transmetimit te energjise elektrike.

Hec Sllabinje ka hyre ne operim dhe ka filluar operimin dhe prodhimin e energjise elektrike qysh ne vitin 2012 dhe ne vitin 2013 ka arritur nje prodhim ne sasine prej 37, 654 MWh, dhe ne vitin 2018 prodhimi vjetor ka arritur ne 44, 035 MWh.

Bordi i ERE me vendimin nr.85, datë 12.05.2020, ka miratuar e “Kriteret për të vendosur derogime për modulet gjeneruese të energjisë elektrike”. Ne kete akt rregullator parashikohet se ne kuptim Nenit 60 te “Kodit të Rrjetit mbi Kërkesat për Lidhjen me Rrjetin te Gjeneruesve” si transpozim i Rregullores KE 2016/631, miratuar anë Vendimin te Bordit te ERE Nr.129 datë 04. 06. 2018, autoriteti rregullator mundet ti japi pronarëve të objektit gjenerues ose pronarëve të ardhshëm, ose Operatorit te rrjetit ne rastin konkret OST-së derogime sipas një ose më shumë dispozitave kodit për modulet gjenerues të rinj dhe ekzistues, ne nje nga format e meposhme me kërkesë të:

1. Pronarit të modulit gjenerues të energjisë elektrike në operim,
2. Pronarit të perspektives të modulit gjenerues; dhe
3. Operatoreve respektiv te rrjetit, OST sh.a. dhe OSSH sh.a.

HEC Sllabinje, klasifikohen si njesi gjeneruese e tipit (D) pasi lidhet ne rrjetin 110 kV. Vendimi nr.85, datë 12.05.2020, i mundesojne Njesive gjeneruese te Tipit (D) te kerkojne derogim.

### **Pershkrim i Derogimit te Kerkuar**

HEC Sllabinja prej vitesh tashme eshte lidhur ne sistemin e transmetimit me rrjetin 110 kV, dhe operojn pa shkaktuar asnje problematike ne kete sistem.

Ligji 43/2015, per sektorin e energjise percakton detyrimet dhe pergjegjesisite e te gjithë aktorëve në sektorin e energjisë, sipas dispozitave të Kodit te Transmetimit dhe Marrëveshjes së Lidhjes. Ne kete kontekst Shoqeria “POWER - ELEKTRIK - SLABINJE” sh.p.k. ka marre miratimin per Lidhjen me rrjetin nepermjet shkreses se OST sh.a. nr. 1128/1 Prot date 19.06.2009. (bashkelidhur shkresa).

Hidrocentrali eshte realizuar me teknologji Kineze, te gjitha paisjet e instaluara jane paisje kineze dhe per rrjedhoje me gjithë perpjekjet e vazhdueshme per te realizuar integrimin e HEC ne sistemin SCADA te OST sh.a., nuk kemi mundur te realizojme kete integrim. Kjo per faktin se sistemi SCADA i OST sh.a. eshte prodhim ABB dhe nuk realizohet nderfaqe me sistemet kineze. Theksojme dhe nje here se pavarsisht kesaj HEC Sllabinja, nuk ka krijuar problematike dhe nuk krijojne problematike ne sistemin e transmetimit. Ne menyre te vazhdueshme kemi pasur kontakte me furnizuesin kinez te paisjeve per te mundesuar integrimin ne Sistemin SCADA te OST sh.a., por kushtet dhe pamundesia per te bere nje vleresim ne vend te situates per shkak se ka kaluar disa vite nga ndertimi dhe venia ne pune e HEC-ve, si dhe pandemia COVID 19, e ka bere te pamundur kete proces.

Per kete ceshtje kemi bere me dije dhe ne takimet dhe komunikimet me OST sh.a. te ndodhur ne keto rrethana jemi te detyruar te kerkojme nje derogim per kete qellim. Dhenia e Derrogimit do te na mundesonte qe te kishim kohen e nevojeshme per te kerkuar zgjidhjen me mundeshme teknike ne menyre qe te realizohet integrimi i HEC Sllabinja, ne sistemin SCADA te OST sh.a.

**Ne keto rrethana kerkojme derogim per percaktimet e nenit 54 paragrafi 1 dhe nenit 55 paragrafi 1 te Kodit te Transmetimit i cili percakton se:**



*Neni 54 paraftafi 1: “Impiantet dhe pajisjet elektrike të Përdoruesve të rrjetit të sistemit të transmetimit nuk do të lidhen ose të vazhdojnë të mbeten të lidhur me rrjetin e Sistemit të Transmetimit, nëse ato nuk janë të pajisur me instalimet e telekomunikacionit si dhe ndërfaqen për lidhjen me Sistemin SCADA/EMS të OST sh.a, duke përmbushur kërkesat e nevojshme për sigurinë dhe operimin normal të rrjetit të sistemit të transmetimit”.*

*Neni 55 Paragrafi 1: “Linjat e telekomunikacionit midis objektit të Përdoruesit dhe rrjetit të telekomunikacionit të OST-së në nënstationet ku do lidhen do kenë ndërfaqe me OST si dhe integrim të paisjeve dhe funksioneve të komunikimit me rrjetin ekzistues të telekomunikacionit të OST-së”.*

Keto derogime te merren ne konsiderate dhe ne marveshjet e nenshkruara me OST sh.a. dhe te mos pengojne operimin normal te HEC te shoqerise “POWER-ELEKTRIK-SLABINJE” sh.p.k. ne rrjet per peridhen e kerkuar te derogimit.

Afati i derogimit te kerkuar eshte 24 muaj, ne menyre qe te krijohet mundesia per gjetjen e nje zgjidhje teknike per integrimin e HEC te shoqerise “POWER-ELEKTRIK-SLABINJE” sh.p.k., ne sistemin SCADA te OST sh.a.

Keto derogime te merren ne konsiderate dhe ne marveshjet e nenshkruara me OST sh.a. dhe te mos pengojne operimin normal te HEC te shoqerise “POWER-ELEKTRIK-SLABINJE” sh.p.k., ne rrjet per peridhen e kerkuar te derogimit.

### **Vleresime ekonomike mbi Derrogimin e Kerkuar.**

Sic edhe evidentuar me siper Shoqëria “POWER-ELEKTRIK-SLABINJE” sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 93, seria PV10K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s Nr. 10, datë 08.02.2010, për një afat 30-vjeçar dhe modifikuar me vendimin e bordit të ERE-s Nr. 95, datë 16.07.2012.

Hec Sllabinje ka hyre ne operim dhe ka filluar prodhimin e energjise elektrike qysh ne vitin 2013 me nje sasi prej 37, 654 MWh, dhe vitet e fundit, ne vitin 2018 prodhimi vjetor ka arritur ne 44, 035 MWh. Ne te njeten kohe per vitin 2019 kane realizuar nje prodhim prej rreth 40, 500 MWh. Per vitin 2020 prodhimi i Shoqërise “POWER-ELEKTRIK-SLABINJE” sh.p.k eshte rreth 43, 900 MWh.

Periudha e koncesioit te formës BOT eshte parashikuar per 35 vjet qe fillon nga data e hyrjes ne fuqi te kontrates. Investimi i koncensionarit i parashikuar ne kontraten koncensionare eshte ne vleren 1,290,117,487 Leke.

Ne baze te kontrates koncensionare eshte parashikuar se Koncensionari duhet te paguaje per llogari te Autoritetit Kontrktor (Shtetit Shqiptar) nje tarife koncensionare te barabarte me 3.5 % te prodhimit vjetor te energjise elektrike.

Nga hyrja ne operim e deri me sot HEC i te shoqerise “POWER-ELEKTRIK-SLABINJE” sh.p.k., ka paguaar ne shtet tarifen koncensionare ne vleren 90,666,884 Leke. Vetem ne 3 videt e fundit ka paguar respektivisht:

Viti 2018	10,587, 224 Leke
Viti 2019	9,243,843 Leke
Viti 2020	7,021,658 Leke

Heqia nga operimi per pamundesia te impelemtimit te nderfaqes me systemin SCADA te OST sh.a. duke marre ne konsiderate cmimin e miratuar nga ERE per kete qellim do ti shkaktonte nje humbje shoqerise vjetore prej rreth 300,000,000 Leke, shifer e cila ndryshon ne varesi te prodhimit dhe cmimit te energjise, dhe per rrjedhoj do te pamundesonte pagesen e tarifes koncensionare per shtetin ne vleren vjetor prej rreth 9,000,000 leke.

Ne te njejten kohe vlen te theksojme se investimet per ndertimin e HEC jane kryer nepermjet linjave te kredise ne bankat e nivelit te dyte dhe aktualisht shoqeria eshte duke paguar keto linja kredie. Pamundesia per operim do te pamundesonte shlyerje e kredise dhe do te krijonte problematike per shoqerine si dhe per banken. (bashkelidhur dokumenti banker qe verteton pagesat e shoqerise per kredine bankare)

Nje element tjetër i rendesishem mbetet edhe elementi social, pasi ne shoqeri ka personel qe punon dhe qe paguhet, te cilet do te humbasin vendin e punes nese do te jemi perball faktit te pamundesise se operimit te hidrocentralit. Ne kete shoqeri punojne rreth 20 punojes te cilet shtohen apo pakesohen ne varesi te nevojave per punime mirmbajtje ose operim.

Vec sa me siper vendi jone eshte nje vend neto importues i energjise elektrike dhe per rjedhoje pamundesia per operim e pune e burimeve gjeneruse si ne rastin konkret te HEC Sllabinja dhe do te ndikonte negativisht duke ulur sasine e energjise elektrike qe gjenerohet ne vend dhe per te rritur importin e saj.

Sikurse evidentuar pamundesia per operim HEC te shoqerise “POWER-ELEKTRIK-SLABINJE” sh.p.k., do te kishte kosto dhe efekte negative te gjithanshme dhe nuk do te sillte asnje element apo perfitim per systemin elektroenergjitik shqiptar, kjo dhe per faktin se pergjat ketyre viteve ne operim HEC nuk ka asnje rekord negative dhe nuk kane krijuar asnje problematike per sigurine e operimit te rrjetit te transmetimit.



**Dokumentacionin shoqerues qe i bashkelidhet kesaj kerkese**

1. Shtojca 1 Format i kerkeses per derrogim nga pronaret e moduleve gjenerues te energjise elektrike.
2. Kontrate e koncesionit e formes BOT (Ndertim, Operim, Transferim) per ndertimin e HEC.
3. Te dhena per banken dhe pagesen e kredise.
4. Shkresen e OST sh.a. per miratimin e lidhjes me rrjetin nr. 1128/1 Prot date 19.06.2009.
5. Numri Identifikues i Subjektit NIPT, etj.

Per gjithë sa parashtuar me siper vlersojme se Shoqëria “POWER – ELEKTRIK - SLABINJE” sh.p.k., ploteson te gjithë kriteret per te kerkuar derrogimin e mesiperm ne menyre qe te realizohet lidhja e hidrocentralit me rrjetin e transmetimit.

Ne keto kushte lutemi te merrni ne konsiderate kerkesen tone.

Me respekt,

**ADMINISTRATOR**

**Power-Elektrik-Slabinje sh.p.k.**

**Naimir KURTI**

*Naimir Kurti*  
  


## Formati i kërkesës për derogim nga pronarët e moduleve gjeneruese të energjisë elektrike

## I- Të dhëna të përgjithshme për aplikantin

Emri	POWER ELEKTRIK - Sllobi nje - S.l.r.p-k	
Selia		
Adresa		
Adresa e emailit		
Nr.telefon		
Faks		
Aplikanti: Numri i Identifikimit në QKR Licensuar nga ERE me Vendim Nr. 10/10 datë Data e lidhjes së Marrëveshjes së Lidhjes.....	<input checked="" type="checkbox"/> Zoteruesi i objektit gjenerues	<input type="checkbox"/> Palë e tretë (nëse moduli është i tipit A)
Të dhënat i përkasin:  (shënojeni kur është e përshtatshme)	<input checked="" type="checkbox"/> Zoteruesi i objektit gjenerues	<input type="checkbox"/> Palë e tretë (nëse moduli është i tipit A)

## II- Person kontakti i aplikantit

Emridhe mbiemri	NAIMIR KURTI	
Pozicioni	Administrator	
Adresaemailit		
Numratetelefonit		
Të dhënat i përkasin: (shënojeni kur është e përshtatshme)	<input checked="" type="checkbox"/> Zoteruesi i objektit gjenerues	<input type="checkbox"/> Palë e tretë

## III-Të dhënat bazë për objektin

Emri		
Tipi i modulit gjenerues (A, B, C, D, sinkron, josinkron)	(D) Sllobi nje	
Lloji i burimit primar të energjisë	Hidro	
Vendndodhja/pika e lidhjes	110 KV	
Kapaciteti instaluar [kW] ose (MW)	13.01 MW	
Tensionii lidhjes [kV]		
Çertifikata e pajisjes lëshuar nga një certifikues i autorizuar (shënojeni sipas nevojës)	Po	Jo
Jetëgjatësia	NA	
Koha e pritshme e vendosjes në punë		



Referenca në dispozitat për të cilat kërkohet kufizimi dhe shkaqet e detajuara	Kodi TR Kodi Lidhjes } PR-derogime
Per sa kohe kërkohet derogimi (jave, muaj, vit)	Nga deri 24 muaj


**IV- Lista e dokumentave**

a) Dokumentat bazë

Prova	Të paraqitura (shënonimë poshtë kur është nevojshme)	
Përshkrimi i moduleve gjeneruese për të cilat kërkohet derogim	Jo	Jo
Përshkrim i detajuar për derogimin që kërkohet	Jo	Jo
Arsyetim i detajuar i shkaqeve së bashku me dokumentat mbështetës dhe analizën kosto-përfitim	Jo	Jo
Demonstrim që derogimi i kërkuar nuk ka efekte të kundërta tek tregëtia ndër- kufitare	Jo	Jo

b) Dokumenta të tjera

Nr.	Emri i Dokumentit
1.	Analiza e koston ne bashkëpunim e operatorin e sistemit ku eshte lidhur gjeneruesi
2.	<del>Bozhtelidh</del>
3.	
4.	
5.	

Vendi dhe data ku është plotësuar kërkesa	Vendi: Tironë Data:
Emri dhe Mbiemri i Personit përgjegjës	MARINA LECATI
Firma e personit përgjegjës dhe vula	

REPubLIKA E SHQIPERISE  
ZYRA E NOTERISE TIRANE

NR. 2326 Rep.  
NR. 669 Kol.



1

3

KONTRATE KONÇESIONI

E FORMES "BOT" (NDERTIM - OPERIM - TRANSFERIM)  
PER NDERTIMIN E HIDROCENTRALIT "SLLABINJE"

Ne Tirane me date 11.04, 2008 (dy mije e tete), para meje notere Dante Peci, e regjistruar ne Dhomen e Noterise Tirane, me adrese Rr. S. Haxhiu u paraqiten palet kontraktuese si me poshte:

Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes percaktuar si "AUTORITET KONTRAKTUES" me Vendimin e Keshillit te Ministrave nr.307, date 25.5.2007 "Per percaktimin e autoritetit kontraktues per ndertimin me koncesion te hidrocentralit "Sllabinje" dhe miratimin e bonusit, ne proceduren perzgjedhese konkurruese, qe i jepet shoqerise", qe me poshte do te quhet i tille, perfaqesuar nga Z. Kristo RODI, i biri i Stefanit, i datelindjes 11.6.1957, madhor dhe me zotesi te plote juridike e per te vepruar, per identitetin e te cilit u sigurova nga leternjoftimi NF Nr. 489018


DHE

Shoqeria "L.N.K." Sh.p.k, regjistruar si person juridik me Vendimin Nr.24244, dt.31.07.2000, te Gjykates se Rrethit Tirane; qe me poshte do te quhet "Koncesionari", perfaqesuar nga administratori Z. Naimir Kurti, i biri i Luanit, i datelindjes 06.03.1976, banues ne Tirane, Rruga " Vellezer Manastirliu ", nr.60/3, per identitetin e te cilit u sigurova nga Pasaporta S 0001441, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Hyrje

Duke patur parasysh qe Qeveria e Shqiperise:

- a) I ka dhene nje rol prioritar prodhimit, transmetimit dhe shperndarjes se energjise elektrike nepermjet ndertimit te hidrocentraleve te rinj, ose rehabilitimit te hidrocentraleve ekzistuese me ane te procedurave te koncesionit, per permiresimin e treguesve teknike dhe ekonomike te rrjetit elektrik kombetar;
- b) Konsideron ndertimin e hidrocentraleve si nje element te rendesishem te politikës se zhvillimit te sektorit te energjise;
- c) Vlereson formen "BOT" te koncesionit, si nje forme koncesioni qe ben te mundur stimulimin e investitoreve private per ndertimin e hidrocentraleve te rinj me anen e kapitalit privat;
- d) Eshte e angazhuar per krijimin dhe zhvillimin e tregut te brendshem te energjise elektrike brenda vendit;
- e) Mirepret investoret vendas ose te huaj ne ndertimin e kapaciteteve te reja prodhuese te energjise elektrike;
- f) Me anen e legjislacionit ne fuqi, rregullon dhenien me koncesion te hidrocentraleve dhe me Vendimin e Keshillit te Ministrave nr.307, date 25.5.2007 "Per percaktimin e autoritetit kontraktues per ndertimin me koncesion te hidrocentralit "Sllabinje",



*[Signature]*

*[Signature]*



autorizohet Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjetike per negociimin dhe nenshkrimin e Kontrates se Koncesionit.

Si dhe:

### Koncesionari

1. Eshte i interesuar te investoje ne ndertimin e hidrocentralit "Sllabinjë", ne komunen Proptisht, rrethi Pogradec, me qellimin prodhimin e energjise elektrike dhe rritjen e sigurise te furnizimit me energji elektrike te zones;
2. Shoqeria "L.N.K." zoteron kapacitetet e nevojshme tekniko-financiare, per te realizuar projektin e miratuar sipas objektit te kesaj marreveshje;
3. Ka kryer studimin tekniko-ekonomik dhe mjedisor per ndertimin dhe shfrytezimin e hidrocentralit "Sllabinjë", objekt i ketij koncesioni;
4. Zoteron aftesite drejtuese, financiare dhe teknike te kerkuara si dhe aftesite per te plotesuar kete iniciative ne perputhje me standartet nderkombetare.

Palet bien dakord per sa vijon:

### Neni 1 Perkufizime

Termat e meposhtem, kudo qe perdoren ne kete kontrate, kane kuptimet qe jepen ne vijim:

- 1.1 **Kontrate Koncesioni** : Eshte kjo kontrate dhe anekset 1 dhe 2 bashkelidhur.
- 1.2 **Autoriteti Kontraktues**: Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes.
- 1.3 **Koncesionari**: Shoqeria "L.N.K.", me seli ne qytetin e Tiranes.
- 1.4 **Hidrocentral**: Teresia e objekteve qe sherbejne per prodhimin e energjise elektrike, ku perfshihen vepra e marrjes, kanali i devijimit, bazeni i presionit, tubacioni qe dergon ujin ne turbina, ndertesa e centralit se bashku me makinerite dhe pajisjet e intaluara ne te, qe ne rastin konkret eshte Hidrocentrali "Sllabinjë", komuna Proptisht, rrethi Pogradec, me fuqi te instaluar 9,300 kW dhe prodhim te energjise elektrike rreth 50,000,000 kWh, se bashku me te gjitha objektet qe permenden me siper.
- 1.5 **Kontratat e siper marrjes**: Te gjitha kontratat e nenshkruara nga Koncesionari me sipermarresit per kryerjen e punimeve;
- 1.6 **Tarifa koncesionare**: Sasia e energjise elektrike qe i ofrohet pa pagese shtetit.
- 1.7 **Projekt-ide**: Dokumentacioni teknik e ekonomik per planifikimin, financimin, projektimin, ndertimin, shfrytezimin, mirembajtjen dhe transferimin e hidrocentralit;
- 1.8 **Projekti i Zbatimit**: Projekti i detajuar inxhinierik, i cili permban parametrat, karakteristikat dhe specifikimet perfundimtare te hidrocentralit.

## Neni 2 Objekti i Konçesionit

Objekti i kesaj kontrate konçesioni eshte ndertimi, shfrytezimi dhe transferimi i hidrocentralit tek Autoriteti Kontraktues, konform termave te kesaj kontrate.

## Neni 3 Afati i Koncesionit

Autoriteti Kontraktues i jep Konçesionarit me konçesion te formes BOT, hidrocentralin "Sllabinje" për një periudhë 35 vjeçare.

Një vit para përfundimit të kësaj periudhe, palët me vullnet të përbashkët mund të zgjasin afatin e kësaj kontrate, kur vlerësohet se, nga ana e Konçesionarit janë përmbushur me korrektësi të gjitha detyrimet dhe Autoriteti Kontraktues e konsideron me interes vazhdimësinë e kontratës.

Kjo periudhë do të fillojë nga hyrja në fuqi e kësaj Kontrate.

## Neni 4 Detyrimet e Autoritetit Kontraktues

Autoriteti Kontraktues merr persiper detyrimet e meposhtme:

- 4.1 Te asistojë koncesionarin prane çdo institucioni, organi a agjencie shteterore, qendrore a vendore, kur eshte e nevojshme, per marrjen e licensave, autorizimeve dhe lejeve qe do t'i sherbejne per ekzekutimin e punimeve dhe implementimin e kesaj kontrate.
- 4.2 Te garantojë koncesionarin se nuk do te lidhe asnje marreveshje tjeter qe mund te demtoje a pengojë prurjet ditore, stinore ose vjetore ne hidrocentral.
- 4.3 Te kontrollojë rregullisht ecurine e kontrates, sipas kushteve te percaktuara ne te.
- 4.4 Te garantojë blerjen e energjise elektrike nga shoqeria KESH sh.a. per 15 vitet e para te prodhimit te energjise elektrike, me cmimin sipas formulese se percaktuar ne Vendimin e Keshillit te Ministrave nr.27, date 19.01.2007.
- 4.5 Te miratojë Projektin e Zbatimit te Hidrocentralit. Koha e nevojshme per miratimin e Projektit të Zbatimit nuk ben pjese ne grafikun e punimeve te parashikuar ne Aneksin 2, bashkëlidhur.

## Neni 5 Detyrimet e Konçesionarit

5.1 Konçesionari eshte i detyruar te zbatojë Projektin dhe objektin e Kontrates ne perputhje me kushtet dhe afatet e parashikuara ne kete kontrate.

5.2 Konçesionari eshte i detyruar:

- a. Te formojë brenda 30(tridhjetë) ditesh nga nenshkrimi i kesaj kontrate shoqerine koncesionare, qe do te kete si objekt te veprimtarise se saj hartimin e projektit zbatimit, ndertimin, shfrytezimin dhe transferimin e hidrocentralit tek Autoriteti Kontraktues pas përfundimit e afatit te koncesionit. Shoqeria koncesionare do t'i nenshtrohet te gjitha dispozitave ligjore, qe rregullojne veprimtarine e shoqerive tregtare ne Shqiperi, si dhe

ne rast transferimi te aksioneve apo pjeseve te kapitalit te saj tek te tretet, duhet te marre pelqimin me shkrim te autoritetit kontraktues.

- b. Te zbatoje punimet dhe planin e investimit sipas Aneksit nr.1 bashkelidhur kesaj kontrate
  - c. Te kryeje investimin sipas afateve te parashikuara ne kete kontrate dhe ne cilesine e kerkuar.
  - d. Te filloje punen brenda 30 ditesh nga data e miratimit te projektit te zbatimit.
  - e. Te menaxhoje dhe administroje hidrocentralin gjate gjithë periudhes se koncesionit.
  - f. Te perballoje shpenzimet qe lidhen me demet qe mund t'i shkaktohen paleve te treta per faj te vet.
  - g. Te informoje Autoritetin Kontraktues per çdo rrethane qe mund ndikojë ne zbatimin e projektit te zbatimit.
  - h. Te zbatoje legjislacioni shqiptar ne fuqi gjate ushtrimit te veprimtarise se saj.
  - i. Te marra masa per te garantuar kushtet e sigurimit ne pune per punetoret dhe personat e tjere, per te shmangur demet ndaj prones publike dhe private, si dhe te respektojë te respektojë legjislacionin ne lidhje me parandalimin e demeve a fatkeqesive ne pune
  - j. Te paguaje te gjitha shpenzimet per publikimet e bera, si dhe shpenzimet noteriale.
  - k. Te paraqese prane Autoritetit Kontraktues projektin e zbatimit sipas grafikut te punimeve, te parashikuara ne Aneksin nr. 2, bashkelidhur.
- Te zbatoje projektin e zbatimit per ndertimin e Hec-it "Sllabinjë".

#### Neni 6

#### Vleresimi i Investimeve

- 6.1 Vlera e investimeve qe duhet te kryhet nga koncensionari (sipas aneksit 1), eshte ne vleren totale 1,290,117,487 (njemiliard e dyqindenedhjetmilion e njeqindeshtatembedhjetmije e katerqindetetehjeteshtate) leke, nga te cilat 620,003,100 (gjashteqindenjzetmilion e tremije e njeqind) leke do te investohen ne makineri e pajisje.
- 6.2 Vlera e mesiperme mund te pesoje ndryshime me marreveshje ndermjet paleve:
  - pasi te jete paraqitur Projekti i Zbatimit;
  - ne çdo kohe gjate zbatimit te projektit ne ndertimin e vepres, sipas efektivitetit te ofertave.
- 6.3 Vlera e ndryshuar e investimit mund te jete me e madhe se 1,290,117,487 (njemiliard e dyqindenedhjetmilion e njeqindeshtatembedhjetmije e katerqindetetehjeteshtate) leke, por jo me e vogel se 1,225,611,612 (njemiliard e dyqindenjzetepesemilion e gjashteqindenjembedhjetmije e gjashteqindedyembedhjetete) leke, qe perfaqeson nje ndryshim te investimit ne vleren 5% te investimit total te parashikuar.

#### Neni 7

#### Programi i Punimeve

Koncesionari merr persiper te zbatoje programin e meposhtem te punimeve :

- 7.1 Koncesionari merr persiper te vere ne pune hidrocentralin brenda 18 (tetembedhjetete) muajve nga marrja e lejes se ndertimit, por jo me vonë se 24 (njetetekater) muaj nga miratimi i kesaj kontrate.

- 7.2 Ky afat mund të ndryshoje me marreveshje midis paleve, nëse marrja e lejeve nga institucionet perkatese vonohet pertej kohes së rregullt proceduriale për marrjen e tyre.

### Neni 8 Zgjidhja e Kontrates së Konçesionit

- 8.1 Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kësaj kontrate në mënyrë të njëanshme:
- Kur koncesionari nuk fillon punë brenda 6 muajve nga data e miratimit të projektit të zbatimit;
  - Në rast të mosrealizimit të fuqisë së vendosur mbi 10 % të asaj sipas projekt-zbatimit të propozuar nga koncesionari;
  - Kur koncesionari transferon kuotat ose kapitalin pa marrë miratimin e Autoritetit Kontraktues.
- 8.2 Kur Autoriteti Kontraktues konstaton, se gjatë afatit të konçesionit, ka shkelje të detyrimeve, kushteve dhe afateve të parashikuara në këtë kontratë, Autoriteti njofton për këtë koncesionarin, duke i kërkuar këtij të japë arsyet për shkeljet e konstatuara brenda një periudhe prej 30 ditësh. Në rast se brenda këtij afati koncesionari nuk pergjigjet, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të zgjidhë këtë kontratë.
- 8.3 Në rast se Autoriteti Kontraktues zgjidh kontratën në mënyrë të njëanshme (pika 8.1 e këtij neni), Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të marrë vlerën e garancisë së kontratës. Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të marrë persipër, perkohesisht administrimin e Hec-it, për sigurimin e një shërbimi efektiv dhe të pandërprerë dhe, në rastin e deshtimit të koncesionarit, të përmbushë detyrimet e tij kontraktuale dhe të deshtimit të tij, për të rregulluar shkeljen e kontratës.
- 8.4 Secila palë, ka të drejtë ta zgjidhë kontratën kur:
- përmbushja e detyrimeve bëhet e pamundur, për shkak të rrethanave që kanë qenë jashtë kontrollit të arsyeshëm të secilës palë;
  - ka shkelje serioze nga njëra palë, shkelje e cila nuk mund të korrigjohet brenda afatit kohor dhe sipas mënyrës së parashikuar në këtë kontratë.
- 8.5 Palët kanë të drejtë ta zgjidhin këtë kontratë me pëlqim të dyanshëm.

### Neni 9 Kontratat

- 9.1 Me qëllim që të realizohet objekti i konçesionit, Koncesionari ka të drejtë të lidhë kontrata siper marrjeje. Në lidhjen dhe nënshkrimin e kontratave të siper marrjes me nenkontraktoret, Koncesionari është i detyruar të respektojë kushtet e kësaj Kontrate.



5

9.2 Pavaresisht nga kontratat e sipermarrjes, Konçesionari mbetet pergjegjes para Autoritetit Kontraktues per zbatimin e rregullt te ketyre kontratave te sipermarrejve. Me perjashtim te detyrimeve qe ka sipas kesaj Kontrate, Autoriteti Kontraktues nuk merr persiper asnje detyrim kundrejt sipermarresve, furnizuesve dhe te treteve. Autoriteti Kontraktues ka te drejten, por jo detyrimin, te nderhyje ne çdo kontrate te koncesionarit.

9.3 Koncesionari nuk ka te drejte ta jape kontraten e koncesionit me nenkoncesion.

#### **Neni 10 Garancite**

10.1 Koncesionari duhet te garantoje, per llogari te autoritetit kontraktues, (sipas formularit te paraqitur ne dokumentet e tenderit) para firmosjes se kontrates, nje shume te barabarte me 10% te vleres totale te investimit prej 129,011,749 (njeqindenzetenentemilion e njembdhjetemije e shtateqindedyzetente) leke.

10.2 Koncesionarit i lejohet te ç'ngurtesoje kete vlere vetem pasi te kete marre konfirmimin nga Autoriteti Kontraktues, brenda 30 diteve nga realizimi i investimit dhe venia ne pune e te gjithe vepres.

#### **Neni 11 Sigurimet**

11.1 Konçesionari siguron hidrocentralin gjate gjithe afatit te koncesionit dhe nje kopje te polices se sigurimit e depoziton çdo vit prane Autoritetit Kontraktues.

11.2 Ne rast se hidrocentrali shkatërrohet ose demtohet per shkaqet per te cilat ai eshte siguruar, zhdentimet financiare qe vijne nga siguracionet do te perdoren nga Konçesionari per te rindertuar, riparuar, dhe rikthyer hidrocentralin ne gjendje e meparshme perpara shkatërrimit ose demtimit.

11.3 Koncesionari duhet te sigurohet per pergjegjesine per demet materiale dhe fizike qe mund t'u shkaktohen paleve te treta, si rrjedhoje e punimeve te ndertimit/montimit te hidrocentralit, si dhe gjate shfrytezimit te tij.

11.4 Sigurimi i objkteve do te kryhet per kufij pergjegjesie jo me te ulet se 200 000 (dyqindmije) Euro per çdo ngjarje, deri ne 500 000 (peseqindmije) Euro ne vit. Pjesa e zbritshme nuk mund te jete me e larte se 1000 (njemije) Euro per çdo ngjarje dhe 2000 (dymije) Euro ne vit.

11.5 Autoriteti Kontraktues do te shenohet si i bashkesiguarar ne te gjitha kontratat e sigurimit.

#### **Neni 12 Kontrolli, Raportimi, Inspektimet dhe Mbikqyrja e Pergjithshme**

12.1 Autoriteti Kontraktues ka te drejte te kontrolloje Konçesionarin gjate gjithe afatit te koncesionit.

12.2 Autoriteti Kontraktues ka te drejte qe ,gjate fazes ndertimit te hidrocentralit te inspektoje dhe kontrolloje punimet per te pare permbushjen e kushteve dhe afateve te percaktuara ne kete Kontrate.

12.3 Konçesionari raporton me shkrim cdo tyre muaj tek Autoriteti Kontraktues per realizimin e programit te punimeve(investimeve), ne vlere dhe ne natyre,dhe pas fillimit te shfrytezimit, çdo gjashte muaj per ecurine e projektit sipas kushteve te kontrates konesionare.

12.4 Autoriteti Kontraktues ka te drejte te mbikeqyre ecurine e punimeve dhe cilesine e kryerjes se tyre, nese jane ne perputhje me programin e punimeve dhe me dokumentacionin e Projektit perfundimtar.

12.5 Ne rast te shkeljeve te Kontrates, konstatuar gjate kontrollit te pergjithshem, Konçesionari do te njoftohet me shkrim per masat qe do te merren dhe detyrat qe do t'i lihen, si dhe menyren dhe afatet e zbatimit te tyre.

### Neni 13

#### Tarifa koncesionare dhe vlere e riinvestimit

13.1 Tarifa koncesionare eshte 3.5 % e energjise se prodhuar,te cilen Autoriteti Kontraktues ka te drejte ta shese kete sasi energjie per llogari te tij.

13.2 Vlere e riinvestimit eshte 70 % e vleres se investimit per makinerite dhe pajisjet. Kjo vlere do te investohet çdo 15 vjet dhe do te aktualizohet sipas indeksit te inflacionit.

### Neni 14

#### Legjislacioni i zbatueshem

Zbatimi dhe interpretimi i kesaj Kontrate Konçesioni do te bazohet ne legjislacionin shqiptar ne fuqi.

### Neni 15

#### Forca Madhore dhe të paparashikuara

15.1 Konsiderohen ngjarje te Forces Madhore katastrofat e natyres, permbytjet, termetet,thatesira, lufta dhe nderhyrja e paleve te treta qe kane fuqine e ligjit dhe çdo ngjarje tjeter e njejte ,qe mund te ndikojne ne permbushjen e kesaj Kontrate, si dhe te detyrimeve reciproke qe papashikohen ne kete Kontrate, qe nuk varen nga vullneti i paleve ose qe nuk kane te bejne me vullnetin e tyre.

15.2 Ne rast se verifikohen vonesa ne realizimin e kesaj Kontrate ose mospermbushje te detyrimeve te Paleve, si pasoje e ngjarjeve te Forces Madhore, vonesat ose mospermbushje nuk mund te sherbejne si baze per çdo pale per te kerkuar zhdemtim nga pala tjeter.

15.3 Kur nje detyrim i kesaj Kontrate nuk do te zbatohet ose permbushet si rezultat i Forces Madhore, pala e demtuar njofton me shkrim palen tjeter, brenda 30 diteve, shtyrjen e afatit te punimeve ose braktisjen e tyre, si dhe/ose masat qe do te merren per kapercimin e pasojave.

15.4 Afati i nderprerjes se punimeve dhe shtyrja ne kohe e tyre ,do te percaktohen nga palet ne nje procesverbal menjehere pas ndodhjes se ngjarjes se Forces Madhore.

## Neni 16

### Hyrja ne fuqi e Kontrates se Konçesionit

Kontrata e Konçesionit do te hyje ne fuqi mbasi te jete miratuar nga Keshilli i Ministrave te Republikes se Shqiperise, ne perputhje me Ligjin Nr.9663, date 18.12.2006 "Per konçensionet".

## Neni 17

### Zgjidhja e Mosmarreshjeve

17.1 Çdo kundërshti, mosmarrëveshje apo ankesë midis palëve kontraktuese që lind ose ka lidhje me zbatimin dhe interpretimin e kësaj Kontrate Konçesioni, do të zgjidhet me mirëkuptim midis tyre duke u bazuar në vullnetin e mirë.

17.2 Kur me gjithë përpjekjet e palëve nuk arrihet një konsensus i përbashkët, kompetente për zgjidhjen e çdo mosmarrëveshje që lidhet me këtë Kontratë Konçesioni, do të jetë Gjykata e Arbitrazhit që do të krijohet dhe funksionojë sipas parashikimeve të neneve 400 e vijues të K.Pr.Civile të Republikës së Shqipërisë.

